



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.872/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada - Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Berat Lahu kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Berat Lahu kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, pas Shpalljes së Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.11.2017 në ora 10:30, ka pranuar një apel nga Berat Lahu kandidatë për anëtarë për Kuvendin Komunal në Prishtinë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, me të cilin pretendon se ka dyshime se qëllimisht një numër i madh i votave të tij i janë shpallur të pavlefshme. Po ashtu ka shtuar se dyshimet për keqpërdorim i ka sidomos në vendvotimet: 1901e, 1917e, 1918e, 1919e, 1920e, 1924e, 1925e, 1927e.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel të apeluesit gjeti se, apeluesi nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të dëshmuar pretendimet e tij në apel. Prandaj, Paneli apelin e apeluesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla apeli i ankuesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.872/2017 me datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.